

Termet e Referencës: Ekspert për Raport mbi statusin e bimëve medicinale në park

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përmes Grantit PONT në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare (PA_028), duke ndjekur planin operacional të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar në monitorimin dhe ruajtjen e specieve treguese si një komponent kyç i menaxhimit të përgjithshëm të zonës së mbrojtur së bashku me habitatet kryesore. Për të siguruar efektivitetin e përpjekjeve tona për ruajtje, ne po kërkojmë një ekspert me përvojë për të kryer një studim në lidhje me "Raport mbi statusin e bimëve medicinale në park".

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a. Të prodhojë një raport mbi statusin e bimëve medicinale në park.

3. Qëllimi

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

-Shtrirja përfshin një qasje, nga kuptimi i karakteristikave të habitatit dhe prodhimi i një raporti mbi statusin e bimëve medicinale në parkun e Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare, që do të ndihmojë AdZM-tw e Shkodrës dhe Kukësit në zbatimin e një plani veprimi për ruajtjen e statusit të bimëve medicinale.

4. Kohëzgjatja

Konsulenca pritet të fillojë më 25 korrik dhe të përfundojë më 1 shtator. Detyra është e përqendruar në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare. Eksperti pritet të dorëzojë një raport mbi statusin e bimëve medicinale në park, duke siguruar shpërndarjen gjeografike dhe të dhënat sasiore.

5. Raportimi

Eksperti do të dorëzojë një raport tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura së bashku me rekomandimet.

6. Kualifikimet

Kandidati ideal duhet të ketë:

- a. 5 - 10 vite përvojë në fushën e ekspertizës së biodiversitetit
- b. Ekspertizë të dëshmuar në përbërjen e habitatit dhe specieve të Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare
- c. Njohuri me kontekstin ekologjik të zonës së projektit.

7. Buxheti

Buxheti për konsulencën referohet linjave të buxhetit:

- Aktiviteti Nr. 3.1 "Raport mbi statusin e bimëve medicinale në park"

Duke bërë vlerën totale të kësaj konsulence 1020 Euro duke përfshirë 15% të taksave.



AGJENCIA
KOMBËTARE
E ZONAVE
TË MBROJTURA

8. Procesi i Aplikimit dhe Afati

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV deri më 22 korrik në adresën info@akzm.gov.al